



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:136806  
Datë: 08.08.2022  
Numri i dokumentit: 03306842

**C.nr.944/19**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, gjyqtari Baki Shigjeqi, në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit “BKS”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Z.B., me banim në rrugën “ ..... ”, nga fshati Kabash komuna e Prizrenit, tash me adresë të panjohur, për shkake të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 357.00 € (treqind e pesëdhjetë e shtatë euro), jashtë seance gjyqësore, me datë 08.08.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** padia me numër C.nr.944/19, e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Z.B., lidhur me çështjen e kompensimit të dëmit material dhe jomaterial.

**A r s y e t i m**

Paditësi Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me datë 26.06.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurit Z.B., me banim në rrugën “ .....”, nga fshati Kabash komuna e Prizrenit, tash me adresë të panjohur, me objekt të padisë rimbursimi i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 357.00 € (treqind e pesëdhjetë e shtatë euro).

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata ka marrë aktvendim me të cilin e ka detyruar të paditurin për dhënien e përgjigjes në padi dhe të njëjtën e ka ekspeduar në adresën e dhënë si në padi nga ana e paditëses. Me rastin e dërgimit të së njëjtës nga shërbimi për dërgimin e shkresave pranë kësaj gjykate, ka qenë e pamundur dërgimi i të njëjtës për shkak se adresa e të paditurit e dhënë në padi nuk është e saktë. Në fletkthesën dërguar të padituите qëndron konstatimi se palët është e pa njohur, andaj Gjykata konsideron se nuk plotëson kushtet në kuptim të dispozitës së nenit 253 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që të veprohet sipas saj, ky fakt vërtetohet nga konstatimi në fletkthesën për dorëzim personal.

Për këtë arsye, gjykata në Aktvendimin e datës 04.07.2022, në kuptim të dispozitës së nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, paditëses ia kthen padinë në përmirësim dhe plotësim me qellim të cilësimit të drejtë dhe të saktë të adresës së të paditurit, ose në kuptim të nenin 79.par.3 të LPK-së, në emër të paradhënies për shpenzimet për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin, t’i deponoj në arkën e kësaj gjykate shumën në lartësi prej 300.00 €(treqind euro), në afat prej 3 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Duke iu referuar këtij aktvendimi pala paditëse, me parashtrësën e 15.07.2022, ka shënuar të njëjtën adresë të palës së paditur – në të cilën adresë gjykata dy herë nuk ka mundur ta ftojë në

mënyrë të rregullt të paditurin, me çka gjykata ka konstatuar se parashtresa është kthyer e pa korrigjuar, dhe as nuk i ka deponuar mjetet për përfaqësues të përkohshëm deri në marrjen e këtij aktvendimi.

Meqë gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë së paditëses për shkak se paditësja brenda afatit të caktuar nga gjykata e ka kthyer parashtresën e pa korrigjuar, dhe as nuk i ka deponuar mjetet për përfaqësues të përkohshëm deri në marrjen e këtij aktvendimi, andaj në pajtim me nenin 102.3 dhe 391 të LPK-së, Gjkata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:136806, 08.08.2022**

**G j y q t a r i**

---

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.